



Partia Demokratike

GRUPI I PUNËS PËR NDRYSHIMET NË STATUT

Nr. 222 Prot.

Tiranë, më 01.05.2026

VENDIM

Nr. 1, datë 01.05.2026

“PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË DHE KALENDARIT TË PUNËS PËR PROPOZIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të 63 të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, dhe vendimit Nr. 35, datë 17.03.2026 të Kryesisë së Partisë Demokratike të Shqipërisë, **Grupi i Punës për mbledhjen e propozimeve për ndryshime në Statutin e PDSH, në mbledhjen e tij të datës 01.05.2026**

V E N D O S I:

1. Miratimin e Kalendarit të Punës për mbledhjen e propozimeve për ndryshime në Statutin e PDSH, si më poshtë vijon:

1 Maj - 10 Maj 2026	Secili anëtar i Partisë, Kryesisë, Këshillit Kombëtar, Grupit Parlamentar, Kuvendit Kombëtar, mund të paraqesë propozime për ndryshime/përmirësime në Statut. Edhe secili anëtar i Grupit të Punës duhet të paraqesë mendime/propozime me shkrim për ndryshime apo shtesa në Statut.
----------------------------	---



11 Maj - 14 Maj 2026	Shqyrtimi i të gjitha propozimeve të paraqitura brenda afatit më sipër nga Grupi i Punës.
15 Maj - 20 Maj 2026	Hartimi i ndryshimeve dhe propozimi final i grupit të punës mbi ndryshimet e mundshme në Statutin e PD. Dorëzimi i ndryshimeve Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë për ndjekjen e procedurave të mëtejshme statutore.
Brenda 25 Maj 2026	Shqyrtimi dhe miratimi nga Kryesia/Këshilli Kombëtar dhe propozimi për miratim në Kuvendin Kombëtar të PD.
30 Maj 2026	Shqyrtimi dhe miratimi nga Kuvendi Kombëtar i PD.

2. Sekretariati Organizativ i Partisë i njofton Kalendarin, të gjithë Degëve të Partisë, të cilat ngarkohen që të mbledhin të gjitha propozimet e anëtarëve të tyre, anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, apo strukturave drejtuese të Degës, përfshirë Kryesisë së Degës, dhe t'i përcjellin ato pranë Sekretarit Organizativ të PDSH z. Ervin Minarolli, **brenda datës 10 Maj 2026, ora 16.00.**
3. Sekretariati Organizativ i Partisë i njofton Kalendarin, të gjithë anëtarëve të Kryesisë dhe të Këshillit Kombëtar, të cilët mund të përcjellin mendimet dhe propozimet e tyre me shkrim pranë Sekretarit Organizativ të PDSH z. Ervin Minarolli, **brenda datës 10 Maj 2026, ora 16.00.**
4. Sekretarja e Grupit Parlamentar të PDSH i njofton Kalendarin, të gjithë deputetëve të Grupit Parlamentar të PDSH, të të cilët mund të përcjellin mendimet dhe propozimet e tyre me shkrim pranë Sekretarit të Grupit Parlamentar të PDSH, **brenda datës 10 Maj 2026, ora 16.00.**
5. Sekretari Organizativ i PDSH dhe Sekretarja e Grupit Parlamentar të PD, brenda datës 10 Maj 2026, ora 23.59, i përcjell të gjitha propozimet e ardhura



nga anëtarët e Partisë, Degët e Partisë, anëtarët e Kryesisë apo Këshillit Kombëtar, të Grupit Parlamentar apo Kuvendit Kombëtar, pranë anëtarëve të Grupit të Punës.

6. Deri në momentin e shqyrtimit dhe miratimit të propozimit nga Kryesia apo Këshilli Kombëtar i PDSH, propozimet, puna dhe produkti i Grupit të Punës për ndryshimet në Statut është konfidenciale dhe mbledhjet e tij janë të mbyllura.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

KRYEATRI I GRUPIT TË PUNËS

FLAMUR NOKA



GAZMENT BARDHI